

Data 17.09.2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Platformë të Integruar për Menaxhimin e Faturimit dhe Parashikimin e Energjisë”**

---

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): - 48000000-8  
- Paketa software dhe sisteme informacioni.

**VLERA E FONDIT LIMIT: 99,289,567** (nëntëdhjetë e nëntë milion e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) (Monedha), **leke pa TVSH, ose 1,080,291.2 (një milion e tetëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një pikë dy) euro pa TVSH.** Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 17.09.2026, 1 euro = 91.91 All.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE Group Sh.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsytimit te meposhtem:**

Kjo kontrate nuk eshte ndare ne lote pasi:

- Komponentët janë teknikisht të ndërlidhur dhe duhet të funksionojnë si një sistem i vetëm.
- Ndarja do të krijonte probleme integrimi midis moduleve, p.sh. faturimit, databazës, analizës së konsumit dhe parashikimit.
- Kërkohet një përgjegjës i vetëm për funksionimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e të gjithë platformës.
- Ndarja në lote do të sillte **rrezik për përputhshmërinë teknike**, vonesa ose paqartësi në përgjegjësitë kontraktore.

- Nga analiza e tregut rezulton se **një operator ekonomik i vetëm** mund të realizojë objektin dhe ndarja nuk do të sillte përfitim real në konkurrencë.
- Vlera dhe natyra e objektit e bëjnë ndarjen **joefektive ose joekonomike**.

Gjithashtu duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit, **“Platformë e Integruar për Menaxhimin e Faturimit dhe Parashikimin e Energjisë”**, vlerësohet se realizimi i tij në një kontratë të vetme është më i përshtatshëm sesa ndarja në lote të veçanta.

Objekti i prokurimit përfshin procese dhe funksionalitete të ndërlidhura, të cilat shtrihen nga **mbledhja dhe administrimi i të dhënave, menaxhimi i faturimit dhe arkëtimit, integrimi me sistemet ekzistuese, parashikimi i konsumit dhe prodhimit, planifikimi dhe nominimi i energjisë, deri te raportimi dhe mbështetja e proceseve të balancimit**. Këto funksionalitete nuk përbëjnë sisteme të pavarura, por komponentë të një zgjidhjeje të integruar, ku cilësia dhe funksionimi i një komponenti ndikojnë drejtpërdrejt në komponentët e tjerë.

Ndarja e objektit në lote të veçanta, për shembull sipas funksionaliteteve të faturimit, parashikimit, integritetit dhe raportimit, do të krijonte nevojën për **integrimin dhe koordinimin e zgjidhjeve të ofruara nga operatorë të ndryshëm ekonomikë**. Një situatë e tillë do të shtonte kompleksitetin teknik dhe operacional, duke krijuar rrezik për mospërputhje ndërmjet sistemeve, vonesa në shkëmbimin e të dhënave, probleme në përcaktimin e përgjegjësisë për defektet dhe vështirësi në garantimin e performancës së platformës si një tërësi.

Në veçanti, duke pasur parasysh se FTL SH.A. administron një numër të konsiderueshëm prej rreth **200 palësh përgjegjëse balancuese**, saktësia dhe disponueshmëria e të dhënave janë të rëndësishme për proceset e parashikimit, nominimit dhe menaxhimit të disbalancave. Për këtë arsye, funksionalitetet e platformës duhet të operojnë mbi **një arkitekturë të përbashkët të të dhënave**, me rregulla të unifikuara për përpunimin, validimin dhe shkëmbimin e informacionit.

Po ashtu, platforma duhet të integrohet me sistemet dhe burimet ekzistuese të informacionit, përfshirë **MPOWER, S-Connect, sistemet/aplikacionet përkatëse të OST SH.A. dhe mjetet ekzistuese të raportimit**, si dhe të reduktojë ndërhyrjet manuale aktualisht të nevojshme. Realizimi nga një kontraktor i vetëm mundëson që **arkitektura, integrimet, siguria, migrimi i të dhënave, zhvillimi, testimi, implementimi dhe mirëmbajtja** të trajtohen në mënyrë të koordinuar dhe nën një përgjegjësi të unifikuar kontraktore.

Për më tepër, ndarja në lote do të mund të sillte **ndarje të përgjegjësisë ndërmjet operatorëve ekonomikë**, duke e bërë më të vështirë identifikimin e përgjegjësisë në rast të problemeve që lindin në ndërveprimin ndërmjet moduleve apo sistemeve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për një platformë që mbështet procese kritike të aktivitetit të FTL SH.A., ku ndërprerjet, pasaktësitë ose vonesat në përpunimin e të dhënave mund të ndikojnë në proceset e furnizimit, parashikimit, nominimit, faturimit dhe menaxhimit të disbalancave.

Për sa më sipër, **ndarja e objektit në lote nuk konsiderohet e përshtatshme nga pikëpamja e integritetit teknik, koordinimit operacional dhe përcaktimit të përgjegjësisë për funksionimin**

**e platformës**, pasi komponentët e saj janë funksionalisht dhe teknikisht të ndërlidhur. Realizimi i objektit në një kontratë të vetme synon të sigurojë një zgjidhje të integruar, ndërveprueshmëri të garantuar ndërmjet të gjithë komponentëve, një arkitekturë të unifikuar të të dhënave dhe **një përgjegjësi të vetme për implementimin dhe funksionimin e të gjithë zgjidhjes**.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ..4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës..9

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

---

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit .....

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë llojin e mallrave dhe koheshtrirjen e kontrates për këtë objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të deshmonte se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim është kërkuar vërtetim i xhiros

per tre vitet e fundit ne nje vlere jo më e vogël se **100%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet .

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”* dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: *“3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlëra e kërkuar jo më e vogël se vlerës së fondit limit, është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Vlëra e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”*.

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlëra e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlerës së fondit limit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe

jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlogaritur të vlerës së fondit limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlogaritur të kontrates/lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlere është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve për vitet ushtrimore (2023, 2024, 2025) të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 (të ndryshuar) atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “2 “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin emnistrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. ”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet

*operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”*

Në nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar përcaktohet se: “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Në nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar, përcaktohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve të tre viteve të fundit financiare, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, më qëllim që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dorëzimi i bilanceve kontabël të konfirmuar nga autoritet tatimore kërkohet për të dëshmuar se kopja e bilancit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi është kopje e njëjtë me atë të paraqitur pranë administratës tatimore.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 35% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilësinë e mallrave të kërkuar në këtë objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të kete realizuar me kontrata të ngjashme, të jete afer limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK krijon siguri dhe besueshmëri që OE ofertues mund të realizojë kontratën prokurimi me sukses dhe pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

---

### **2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:**

#### **2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:**

**a)** Certifikate ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) për sistemin e menaxhimit të cilësisë, OSE EKUIVALENTE (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

**b)** Certifikate ISO 27001:2022 për Sigurinë e Informacionit, OSE EKUIVALENTE (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë

*Certifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi ISO 9001:2015 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilesore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilesive implementuese.

Certifikimi ISO 27001:20252 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rendesi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këto kontrate do të ketë upgrade të sistemeve që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale, pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për licensat/produktet software të ofruara nga Operatori Ekonomik në këtë objekt prokurimi për territorin e Shqipërisë.

*Në rast të paraqitjes së autorizimit të prodhuesit/distributorit të autorizuar, autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit të autorizuar si: telefon, fax, e-mail, website, kjo është e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sqarohet se:

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës të mallrave/shërbimeve që kërkohen në procedurë, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikepamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre mallrave/shërbimeve sipas kërkesave në specifikimet teknike.

Për të garantuar me sukses përmbushjen e të gjithë kërkesave teknike gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, për të garantuar zgjidhjen e problemeve të paparashikuara që mund të hasë OE gjatë kryerjes së proceseve të punës deri në dorëzim të plotë të kontratës, nevojitet të kenë mbështetje

nga prodhuesi për rastet e përballjes me situata të paparashikuara si dhe për zgjidhjen e problematikave të mundshme gjatë fazës së realizimit të projektit.

Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për produktet software ose komponentet që ofrohen falas nga prodhuesi të cilat vetëm shpërndahen por nuk shiten, nuk është i nevojshëm autorizimi por mjafton që OE të përmendë emrin e komponentit, burimin ku do ta marrë psh website zyrtar, dhe një burim në internet ose dokument të vërtetueshëm nga AK ku përcaktohet që prodhuesi ose distributori i saj e ofron falas dhe lejon shërndarjen për këdo.

**2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë propozim teknik që i jep zgjidhje të gjithë kërkesave dhe specifikimeve teknike. Nuk do të pranohen propozime teknike të cilat vetëm sa pohojnë kërkesat pa paraqitur zgjidhjen konkrete të propozuar nga operatori ekonomik. Në propozimin teknik operatori ekonomik duhet të jetë i sakt dhe të përmbajë:**

- emertimet e teknologjive me versionet perkatese dhe zgjidhjeve që do të perdore dhe menyra e perdorimit të tyre për të kuptuar se çfare kerkese teknike zgjidh,
- metodologjine e punes ku perfshihet implementimi dhe mirembajtja,
- hierarkine e stafit të propozuar me emrat e punonjesve dhe roli konkret gjate zbatimin e kontrates sipas tabelës që vijon:

| Roli                                | Emri i punonjesit | Certifikata |
|-------------------------------------|-------------------|-------------|
| Menaxher projekti                   |                   |             |
| Menaxher i nivelit të shërbimit     |                   |             |
| Arkitekt software                   |                   |             |
| Programues software                 |                   |             |
| Programues software                 |                   |             |
| Programues software                 |                   |             |
| Programues software                 |                   |             |
| Administrator i bazës së të dhënave |                   |             |
| Ekspert i proceseve të biznesit     |                   |             |
| Ekspert BI                          |                   |             |
| Administrator sistemi operimi       |                   |             |
| Ekspert kontejnerizimi              |                   |             |

|                                 |  |  |
|---------------------------------|--|--|
| Ekspert orkestrimi kontejnerash |  |  |
| Ekspert sigurie kibernetike     |  |  |
| Testues software                |  |  |
| Trajnues                        |  |  |

Te gjithë rolet duhet te plotesohen nga punonjes me certifikaten perkatese sic kerkohet ne piken 3.

Nje punonjes mund te kete jo me shume se 2 role.

- politikat e licensimit qe do te dorezoje per produktet qe do te propozoje.

Propozimi teknik, me ngarkesen dhe angazhimet qe do te propozohen nga operatori ekonomik, duhet te justifikojë menyrën e ofertimit ekonomik neper zerat perkates. Nuk do te pranohen ofertime te cilat kane ofertim ekonomik jo te justifikuar nga menyra e zbatimit te projektit sipas propozimit teknik. Mos plotesimi i ketij kriteri kualifikues per propozimin teknik me te gjithë elementet perberes te tij dhe sipas argumentimit shoqerues sjell si pasoje skualifikimin e ofertave te operatoreve ekonomik.

**Argumentimi:** Kjo lloj kërkesë ekziston për të mbrojtur AK nga disa rreziqe konkrete në prokurim:

1. Zbulon dhe ve ne dukje ofertat e kopjuara dhe jo-angazhuese

Nëse ofertuesit do të ripërsërisin kërkesat pa thënë si do t'i përmbushin ato, AK nuk do të kishte asnjë mënyrë për të vlerësuar kompetencën, fizibilitetin ose për të bërë dallimin midis operatoreve ekonomik. Kërkesa për zgjidhje konkrete (teknologji, versione, arkitekturë specifike) i detyron ofertuesit të mendojnë mirë dhe të angazhohen për një qasje reale.

2. Parandalon paqartësinë dhe ndihmon ne ofertimin e cmimeve realiste

Propozimet teknike të paqarta mund ti shtyjne OE te ofertojne me cmime jo realiste dhe emërtimi i teknologjive, versioneve dhe zgjidhjeve të sakta, e shmang kete risk. Një çmim ka kuptim vetëm në kontekstin e produktit/sherbimit që qëndron pas tij. Nuk do te kishte kuptim qe sipas tabelës se cmimeve e cila ndahet ne faza, per shembull ne fazen e pare e cila duhet te perfundoje brenda 1 muaji nga nenshkrimi i kontrates, OE te faturoje 99% te te gjithë kontrates dhe 1% ta shperndaje neper gjithë zerat e tjere.

3. Krijon llogaridhënie mbi stafin dhe përgjegjësinë dhe garanton cilesi ne cdo faze dhe rol

Kërkimi i hierarkisë së stafit të propozuar dhe "kush bën çfarë" do të thotë që AK mund te vleresoje kapacitetet reale te OE qe do te ofertojne. Per shembull nuk do te ishte realiste dhe do te shfaqte risk te lart per zbatimin e kontrates nese nje OE propozon 1 person qe permban 12 certifikata dhe mbulon 12 role ose qe 1 person permban 12 certifikata por mbulon vetem 1 rol dhe detyrat e tjera do te kryhen nga persona qe nuk kane asnje certifikim.

2.3.5 Ofertuesi për të vertetuar që ka kapacitete njerezore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike, duhet të ketë të punësuar jo më pak se 16 (gjashtëmbëdhjetë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike, etj), të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit (marre si referencë datën e hapjes së ofertave).

**Argumentim:** Për realizimin e këtij shërbimi kërkohet që në secilën nga fushat kryesore të projektit, operatori ekonomik të përdori personel teknik të mjaftueshëm dhe të kualifikuar. Fushat e ekspertizës si dhe numri i personelit të certifikuar, janë kryer në bazë të komponenteve të projektit si dhe të masës së angazhimit të specialistëve. Në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike, etj), është kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe termat e referencës.

**Këta punonjës duhet të kenë certifikimet si vijon:**

**a. Të paktën 4 (kater) programues software të certifikuar në implementim ose zhvillim të zgjidhjes software të propozuar ose ekuivalent.**

**Argumentim:** Kriteri garanton AK për aftësitë profesionale të punonjësve që ka OE Ofertues. Përfshirja e 4 (kater) programues/zhvillues software të certifikuar në zgjidhjen e propozuar garanton implementimin e të gjithë specifikimeve të kërkuara nga AK duke zbatuar zgjidhjen e propozuar nga OE. Gjithashtu këta specialistë garantojnë vijueshmerinë normale të punës për gjatë gjithë periudhës së kontratës. Objekti i rëndësishëm i sistemit dhe shërbimet që kërkohej të përfitohen nepermjet kësaj kontrate janë shumë të rëndësishme për FTL dhe implementimi dhe programimi duhet të jetë sipas standardeve me të mira të zgjidhjeve enterprise.

**b. Të paktën 1 (një) administrator bazash të dhënash të certifikuar për bazën e të dhënave të propozuar ose ekuivalent.**

**Argumentim:** Ky kriter është i lidhur me specifikimet teknike. Është e qartë që në sisteme informacioni enterprise baza e të dhënave është komponent shumë i rëndësishëm për ruajtjen e të dhënave në mënyrë të sigurt, leximin e tyre në mënyrë të saktë dhe të shpejtë, ruajtjen e të dhënave nga nderhyrjet e pa autorizuar, konfigurimin e përdoruesve dhe aksesëve sipas rrolit që duhet të kenë, integrimi me sisteme të tjera për arsye gjurmimi, sigurie, monitorimi etj. Të gjitha këto duhet të konfigurohen në mënyrë të optimizuar që sistemi të funksionojë me një shpejtësi të përshtatshme. Të gjithë këto veprime dhe jo vetëm lidhur me bazën e të dhënave garantohej kur kryhen nga një person i certifikuar për bazën e të dhënave të propozuar.

**c. Të paktën 1 (një) menaxher projekti me certifikatë “PMP” ose ekuivalent.**

**Argumentim:** Ky kriter garanton AK që operatori ekonomik ka në përbërje të tij stafin me aftësi profesionale në mënyrë që i gjithë projekti të realizohet sipas të gjitha kërkesave dhe afatëve të përcaktuara në DST dhe specifikimet teknike. Punonjësi i certifikuar si menaxher projekti garanton organizimin e njerezve dhe burimeve të OE për të patur zbatim të suksesshëm të projektit sipas standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare duke

marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti që prej analizës deri në implementim e dorezim të plote.

**d. Të paktën 1 (një) menaxher i nivelit të shërbimit me certifikate “ITIL” ose ekuivalent.**

**Argumentim:** Pas perfundimit të implementimit, OE duhet të kryejë mirëmbajtjen e sistemit ashtu siç kërkohej në specifikime teknike. Për të garantuar mirëmbajtjen dhe respektin e të gjithë kërkesave për shërbime SLA, OE duhet të ketë një person të certifikuar për ITIL ose ekuivalent për të garantuar të gjithë kërkesat e AK gjatë fazës së mirëmbajtjes.

**e. Të paktën 1 (një) profesionist në proceset e biznesit BPM me certifikate për BPM ose ekuivalent.**

**Argumentim:** Kjo kërkesë lidhet me kërkesat në specifikimet teknike ku kërkohej zëvendësimi i proceseve manuale në procese të digjitalizuara dhe të automatizuara. Për dizajnimin e workflow në mënyrë efektive dhe efikente, është e nevojshme që ajo të bëhet nga profesionist në fushën e “business process management”. Automatizimi i proceseve është, para së gjithash, një problem biznesi, jo vetëm teknik. Ai harton procesin real siç është në praktikë dhe e ridizajnon në mënyrë kritike para automatizimit. Bën lidhjen mes palëve të biznesit dhe zhvilluesve. Formalizon rregullat dhe rastet e vecanta të nënkuptuara të cilat sistemet e automatizuara nuk mund t'i "improvizojnë" siç bën një njeri. Përcakton tregues të matshëm (KPI) si koha e ciklit, shkalla e gabimeve, kostoja që suksesi të vërtetohet dhe vlerësohet më pas. Menaxhon ndryshimin dhe pranimin nga stafi, pasi automatizimi ndryshon punën e njerëzve dhe mund të anashkalohet nëse nuk trajtohet mirë. Dhe në mjedise të rregulluara, siguron që kontrolli i pajtueshmërisë (compliance) të futura në procesin manual të mos humbasin gjatë kalimit në sistem automatik.

**f. Të paktën 1 (një) arkitekt software i certifikuar për arkitekturë sistemesh informacioni enterprise ose ekuivalent.**

**Argumentim:** Bazuar në specifikimet teknike, një ekspert i tillë nevojitet sepse implementimi i një sistemi enterprise ndikon në katër shtresat e arkitekturës: Business, Data, Application, dhe Technology dhe këto duhet të projektohen në mënyrë të koordinuar, jo izoluar. Përmes ADM (“Architecture Development Method”), ai përcakton “Baseline Architecture” siç është dhe “Target Architecture” siç duhet të jete dhe harton “Gap Analysis” për të identifikuar ndryshimet strukturore të nevojshme. Në nivel “Business Architecture”, siguron që procese, role dhe funksione të jenë të përafruara me objektivat strategjike. Në nivel “Data Architecture”, përcakton modelet e të dhënave, pronësinë (data ownership), dhe rrjedhat e integritetit për të shmangur redundancë apo mospërputhje mes sistemeve. Në nivel “Application Architecture”, vendos si aplikacioni i ri integrohet me sistemet ekzistuese. Në nivel “Technology Architecture”, siguron përputhshmëri me infrastrukturën aktuale. Përdor “Architecture Governance” për të siguruar konsistencë, kontroll ndryshimesh, dhe respektim të parimeve arkitekturore afatgjata të organizatës duke parandaluar që vendimet e projektit të krijojnë "technical debt" apo arkitekturë të fragmentuar. Këto projektim në arkitekturën e software të këtij niveli nuk mund ta bëjë asnjë nga personat e tjerë përveç ekspertit të arkitekture në sisteme enterprise.

**g. Të paktën 1 (një) ekspert raportimi dhe inteligjence biznesi certifikuar për BI ose ekuivalent.**

**Argumentim:** Bazuar në specifikimet teknike, ky sistem i gjere menaxhimi, ka të domosdoshme implementimin e raporteve BI dhe të gjithë specifikave që këto raporte të jenë të vlefshme, të shpejta, të besueshme dhe të zbatojnë të gjithë standardet e një sistemi enterprise. Siç janë praktikatat e përgjithshme me të mira në fushën e IT, këto aspekt e mbulon me se miri një ekspert i certifikuar

per BI qe bashkevepron me analistin e biznesit, perdoruesit, zhvilluesit, arkitektin e zgjidhjeve enterprise, menaxherin e projektit, etj. per te dhene rezultatin e pritur nga perdoruesit.

***h. Të paktën 1 (një) administrator sistemesh operimi i certifikuar per sistemin e operimit te propozuar ose ekuivalent.***

**Argumentim:** Sic përmendet edhe në specifikimet teknike, zgjidhja do te instalohet ne datacenter te OSHEE dhe nder detyrat eshte konfigurimi i OS per te dhene siguri dhe performance sipas nevojave qe ka zgjidhja e propozuar nga OE dhe kufizimeve dhe kerkesave qe ka OSHEE. Keto aktivitete garantohen kur kryhen nga specialist te certifikuar ne sistemin e operimit qe OE propozon.

***i. Të paktën 1 (një) ekspert konjnerizimi çertifikuar për zgjidhjen e propozuar per kontejnerizim ose ekuivalent.***

**Argumentim:** Kjo kërkesë lidhet ngushtë me specifikimet teknike. Një punonjës me njohuri të tilla të certifikuara garanton AK për përmbushjen e instalimit dhe konfigurimit në mënyrën më të mirë të container që do të përzgjidhjet nga OE. Njohuritë e personit te certifikuar per kontejnerizimin e propozuar garanton AK qe OE do te beje punen sipas standardeve te shpresuara.

***j. Të paktën 1 (një) ekspert orkestrimi kontejnerash të certifikuar për zgjidhjen e propozuar per orkestrim te kontejnerave ose ekuivalent.***

**Argumentim:** Kjo kërkesë lidhet ngushtë me specifikimet teknike. Një punonjës me njohuri të tilla të certifikuara garanton AK për përmbushjen e instalimit dhe konfigurimit në mënyrën më të mirë të “container orchestration” që do të propozohet nga OE.

***k. Të paktën 1 (një) profesionist per sigurinë kibernetike me certifikate “CISSP” ose ekuivalent.***

**Argumentim:** Kjo kërkesë lidhet ngushtë me specifikimet teknike. Lidhur me nevojat per te patur nje sistem jo vetem te besueshem dhe performant por edhe te sigurt, eshte e domsdoshme qe sistemi te implementohet duke patur parasysh parimet me te mira te sigurise qe ne fillim. Nje ekspert me certifikimin “CISSP” ndihmon qe siguria te mos lihet si nje shtese ne fund te projektit, por te ndertohet nje sistem i sigurt qe ne design. Ky ekspert bashkepunon me arkitektin e sistemit, programuesit, analistin e biznesit per te ndertuar nje sistem te sigurt qe ne gjeneze.

***l. Të paktën 1 (një) testues software i certifikuar per testim software ose ekuivalent.***

**Argumentim:** Kjo kërkesë lidhet ngushtë me specifikimet teknike. Një Testues i Çertifikuar sjell një metodologji të strukturuar, të njohur ndërkombëtarisht për ta bërë këtë, në vend të testimit ad-hoc. Ata aplikojnë teknika formale të dizenjimit të testeve për të siguruar që rastet e testimit mbulojnë rastet e vecanta jo vetëm rastet e zakonshme që një zhvillues kontrollon pergjithesisht edhe vet. Ata strukturojnë testimin nëpër nivele - njësi, integrim, sistem dhe pranim (UAT) duke siguruar që defektet të kapen herët, pasi një gabim i gjetur në prodhim kushton shumë më tepër dhe mundte shkaktoje shume dëm. Ata menaxhojnë vetë procesin e testimit: planifikimin e

testimit, gjurmueshmërinë (hartëzimi i rasteve të testimit përsëri në kërkesa), menaxhimin e defekteve dhe kriteret e daljes duke i dhënë klientit prova objektive nëse sistemi është në të vërtetë gati për t'u vënë në punë, jo vetëm me ndjesi dhe mendime subjektive. Ato janë kritike edhe për testimin jo-funksional sic janë performanca, ngarkesa, përdorshmëria dhe testimin e regresionit, fusha që zhvilluesit shpesh i anashkalojnë sepse përqendrohen në korrektësinë funksionale. Testimi i pavarur dhe metodik është ai që i lejon klientit të vërtetojë se zgjidhja e ofruar i plotëson në të vërtetë specifikimet e përcaktuara në propozimin teknik, përpara pranimi përfundimtar dhe nënshkrimit të pagesës.

**m. Të paktën 1 (një) trajnues te certifikuar si trajner profesionist ose ekuivalent.**

**Argumentim:** Një person me kete certifikatë nevojitet sepse implementimi i një sistemi enterprise nuk përfundon me go-live, suksesi i tij real varet nga sa mirë përdoruesit e adoptojnë dhe e përdorin siç duhet sistemin e ri. Certifikata dëshmon aftësi të strukturuar në metodologjinë e trajnimit, jo thjesht njohuri teknike mbi sistemin, pra dikush që di si të transmetojë njohuri në mënyrë efektive, jo vetëm çfarë të transmetojë.

- n. Në kontekstin e një projekti implementimi, roli i tij përfshin:
- o. Hartimin e planit të trajnimit - identifikon grupe të ndryshme përdoruesish (end-users, administratorë, power-users) dhe përshtat përmbajtjen dhe metodën sipas nevojave dhe nivelit teknik të secilit grup.
- p. Zvogëlimin e rezistencës ndaj ndryshimit - një nga arsyt kryesore pse projektet e implementimit dështojnë (ose "dështojnë në heshtje", kur stafi kthehet te proceset e vjetra manuale) është trajnimi i dobët ose mungesa e tij. Një trainer profesionist e adreson këtë me menyrë profesionale të provuara.
- q. Krijimin e materialeve trajnuese të qëndrueshme - manuale, video, ushtrime praktike - që mbeten si burim pas përfundimit të projektit, jo vetëm sesione një-përdorimshme.
- r. Vlerësimin e efektivitetit të trajnimit - përdor teknika për të matur nëse përdoruesit vërtet kanë përvetësuar aftësitë e nevojshme (jo vetëm prezencë në sesion), gjë që lidhet direkt me suksesin afatgjatë të adoptimit.

**Shenim:** Nje punonjes mund te kete me shume se nje certifikate.

*Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për të gjithë punonjësit e mesiperm pjese e stafit të punësuar nga vete OE, duhet të paraqiten certifikatat perkatëse të kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet të vërtetojë se i ka të punësuar për muajin e fundit marr si reference datën e hapjes së ofertave.*

*Nje punonjes mund te kete nje ose disa certifikime, për të përmbushur kriteret e mesiperme për certifikimet. Si përmbledhje, operatori ekonomik duhet të paraqesi:*

1. *Certifikatat perkatëse të kualifikimit për secilin nga specialistet e mesiperm;*
2. *Kontratën/at e punës konform legjislacionit në fuqi të lidhura me stafin e nevojshëm dhe CV;*

3. *Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo çdo dokumentacion tjetër vertetues, për muajin e fundit marr si reference datën e hapjes së ofertave”.*

Në lidhje me certifikatat e kërkuara, pranohen dhe certifikatat ekuivalente të lëshuara nga institucione certifikuese kombëtare ose ndërkombëtare.

**Sqarim :** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Specifikimet teknike dhe fondi limit jane hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor, ndersa kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga specialisti i fushes.*